



Funded by  
the European Union

**EU4MUNICIPALITIES**

# MANUALI I KOMUNIKIMIT DHE VIZIBILITETIT

**2022**



Shoqata e Bashkive  
të Shqipërisë

*Strategjia e Komunikimit të Projektit është përgatitur nga njësia e komunikimit në Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në kuadër të Projektit BE për Komunitat.*

*Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e projektit "BE për Bashkitë" dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.*

## **PËRMBAJTJA**

RRETH PROJEKTIT	4
PËRSE KY MANUAL?	5
KRITERET E KOMUNIKIMIT	6
PËRDORIMI I LOGOS DHE ELEMENTEVE TË VIZIBILITETIT	6
KOMUNIKIMI NË MEDIAT SOCIALE	7
SQARIM (DISCLAIMER)	8
ANEKS 1- Formati i planit të komunikimit	9
ANEKS 2- Shembull vendosja e logove në dokumente, raporte, prezantime	9
ANEKS 3- Shembull vendosja e logove në video	10

## RRETH PROJEKTIT

BE për Bashkitë është projekt i ri i financuar nga Bashkimi Evropian. Qëllimi tij është të mbështesë potencialin zhvillimor të bashkive dhe të përmirësojë kushtet socio-ekonomike dhe mjedisore të komuniteteve lokale në Shqipëri. Projekti BE për Bashkitë do të mbështesë zhvillimin e infrastrukturës vendore duke mundësuar shërbime publike më cilësore dhe zhvillim ekonomik vendor të qëndrueshëm. Projekti do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe perspektivës për qytetarët shqiptarë në komunitetet e tyre.

### ***Dy objektivat specifike të projektit janë:***

- ▶ Të mbështesë bashkitë në zbatimin e objektivave dhe planeve të tyre strategjike të zhvillimi;
- ▶ Të përforcojë kapacitetet e bashkive për përthithjen dhe menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian.

Prioritet i projektit **"BE për Bashkitë"** është mbështetja e proceseve strategjike, cilat do t'iu mundësojnë aktorëve të qeverisjes lokale të mobilizojnë burimet për të zbatuar planet dhe strategjitë e tyre. BE për Bashkitë do të ndihmojë në krijimin e një praktike më të mirë për qeverisjen vendore dhe qytetarët se si duhet të përcaktohen, konsultohen dhe zbatohen përparësitë e zhvillimit të komuniteteve lokale dhe roli i drejtpërdrejtë që BE mund të ketë në përmirësimin e qeverisjes dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Përmes mbështetjes së bashkive në Shqipëri, projekti do të ndikojë në zhvillimin dhe rritjen e kontributit të tyre në procesin e integritit të vendit në Bashkimin Evropian.

## **PËRSE KY MANUAL?**

Manuali i komunikimit dhe vizibilitetit është një dokument i cili do të përdoret nga bashkitë fituese të skemës së granteve të "BE për Bashkitë", i financuar nga Bashkimi Evropian, për të siguruar mjetet dhe formën e duhur të komunikimit me qëllim informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit tek grupi i synuar mbi projektin dhe ndikimin e tij.

Komunikimi dhe vizibiliteti janë element thelbësor që duhet ndjekur në çdo fazë të zbatimit të projekteve ndaj ky manual sjell udhëzime për mjetet e komunikimit që mund të përdoren, duke përfshirë, por mos u kufizuar, ato tradicionale (TV, radio) apo digjitale (mediat sociale: Facebook, Instagram, Twitter, YouTube), si dhe përfshirjen e elementëve të vizibilitetit në materiale të caktuara. Ky manual është hartuar në bazë të rregullave të përgjithshme të komunikimit dhe vizibilitetit të Bashkimit Evropian . Informacionet dhe rregullat e paraqitura në këtë manual shërbejnë për të udhëzuar vetëm përfituesit e granteve në hartimin dhe shpërndarjen e materialeve të komunikimit. Në të gjitha rastet, çdo plan i komunikimi dhe material i vizibilitetit që do të hartohet duhet të marrë aprovimin paraprak nga personi përgjegjës i komunikimit të projektit "BE për Bashkitë".

## KRITERET E KOMUNIKIMIT

**Kriteret kryesore të komunikimit që duhet të ndiqen nga bashkitë fituese në thirrjen e parë të skemës së granteve nga "BE për Bashkitë" përfshijnë:**

- a) Hartimin planin e tij të komunikimit dhe vizibilitetit nga çdo bashki për projektet e tyre, i cili duhet të plotësojë kriteret dhe rregullat e Bashkimit Evropian. Elementë kryesor të një plani komunikimi përfshijnë:
  - Objektivat e komunikimit;
  - Identifikim i publikut kryesor;
  - Mesazhet kryesore;
  - Kanalet e komunikimit
  - Aktivitetet;
  - Afatet kohore;
  - Buxhetin;
  - Treguesit për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunikimit.
- b) Komunikimi duhet të jetë në të njëjtën linjë me strategjinë e komunikimit të projekti "BE për Bashkitë".
- c) Komunikimi duhet të jetë i orientuar drejt rezultateve konkrete të projektit dhe jo në çështjet administrative të tij.
- d) Komunikimi duhet të jetë i përqendruar tek njerëzit dhe ata duhet të përfshihen në historitë pasi janë përfituesit kryesor të projektit.
- e) Mesazhet kryesore duhet të jenë të shkurtra, të qarta dhe origjinale (mbani parasysh mesazhet kryesore nuk janë slogane dhe nuk duhet të jenë të tillë). Ato duhet të jenë në të njëjtën linjë me mesazhet kryesore të BE për Bashkitë.
- f) Në të gjitha materialet e komunikimit dhe vizibilitetit duhet theksuar se projekti XXX zbatohet me mbështetjen e programit "BE për Bashkitë", i financuar nga Bashkimi Evropian.
- g) Informacionet që përcjellën duhet të jenë të sakta dhe të bazuara në fakte.
- h) Të përdoret gjuhë e thjeshtë (sugjerojmë se duhet ketë një kombinim ndërmjet gjuhës formale dhe zhargonit të përditshëm në rast se e konsideroni të arsyeshme për ta bërë më të lehtë dhe tërheqës mesazhin për publikun).
- i) Komunikimi duhet të jetë interaktiv dhe i përshtatshëm për të gjitha kanalet.
- j) Konsultoni dokumentin këtu për rregullat e komunikimit sipas standardeve të BE-së.
- k) Çdo material komunikimi (njoftimet për shtyp, ftesa, etj.,) dhe vizibiliteti (poster, rroll-up banner, video) përpara një aktiviteti apo publikim në mediat sociale duhet të marrë miratimin 5-7 ditë përpara nga personi përgjegjës i komunikimit të "BE për bashkitë".

## PËRDORIMI I LOGOS DHE ELEMENTEVE TË VIZIBILITETIT

**Logot të cilat duhet të përdoren gjerësisht në materialet e komunikimit dhe vizibilitetit janë logo e Bashkimit Evropian dhe projektit "BE për Bashkitë".**

Logo e Bashkimit Evropian



Logo e projektit "BE për Bashkitë"



**Gjithashtu, në çdo material do të përdoret edhe logo e bashkisë fituese. Pozicioni i logove duhet të jetë:**

- Logo e Bashkimit Evropian: Në fund të faqes, në anën e majtë
- Logo e projekti "BE për Bashkitë": Në fund të faqes, në anën e djathtë
- Logo e bashkisë përfituesve: Në krye të faqes, në anën e majtë

*(shikoni aneksin 2 dhe 3 për pozicionin e duhur të logove në materiale të ndryshme vizibiliteti)*

**Logo duhet të përdoret në:**

- Të gjitha materialet promovuese të prodhuara digjitale/print në kuadër të projektit;
- Njoftime për shtyp, ftesa, raporte, dokumente zyrtare të projektit;
- Në mediat sociale;
- Poster, Infografika, Broshura, fletëpalosje; Rroll-up banner;
- Artikuj promovues;
- Agjenda, listë prezencë të aktivitete të projektit;
- Fushatat informuese;
- Aktivitet publike;
- Video, prodhime audio-vizuale, Fotografi;
- Konferenca për shtyp;
- Vizita në terren;
- Automjete, pajisje, materiale të tjera;
- Pllaka të mirënjohjes dhe panele informative;

**Kujdes!! Logot duhet të jenë 1.5 cm të larta dhe qartësisht të dukshme. Ato nuk duhet të streçohen, të mbivendosen apo t'u ndryshohet ngjyra. Çdo material i prodhuar i vizibilitetit duhet të rishikohet dhe miratohet 5-7 ditë përpara publikimit apo zhvillimit të aktivitetit nga personi përgjegjës i komunikimit të projektit "BE për Bashkitë".**

## **KOMUNIKIMI NË MEDIAT SOCIALE**

**Pjesa më e madhe e komunikimit nga bashkitë fituese duhet të zhvillohet online përmes mediave sociale:**

- Facebook;
- Instagram;
- YouTube;
- Twitter.

Bashkitë duhet të kenë llogari aktive të paktën në faqen në Facebook dhe gjithashtu në Instagram mediat e tjera sociale si Twitter dhe Youtube janë opsionale.

**Përmbajtjet dhe mesazhet në mediat sociale duhet të jenë të lidhura direkt me tematikën e projektit tuaj dhe çdo publikim duhet të:**

- Në fund të çdo postimi duhet të dalë qartë që projekti është i mbështetur nga skema e granteve e "BE për Bashkitë" i financuar nga Bashkimi Evropian.
- Duhet të përdoret hashtagu #EU4Municipalities ose #BEpërBashkitë;
- Krijohet hashtagu i projektit tuaj (#PROJEKTIJUAJ);
- Publikoni informacione, mesazhe shoqëruar me foto nga aktiviteti;
- Çdo përshkrim/ post duhet të jetë i shoqëruar me foto cilësore nga aktiviteti apo dizajnët e prodhuara;

- Të keni të paktën 3-4 publikime në muaj për projektin në fjalë;
- Etiketoni (tag) në çdo postim faqen e BE për Bashkitë dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian (profilet e tyre në mediat sociale i gjeni në tabelën më poshtë)

	Facebook	Instagram	Twitter
BE për Bashkitë	@EU4Municipalities	@eu4municipalities.al	@eu4_m
Delegacioni i BE-së në Shqipëri	@eu.delegation.albania	@euinalbania	@EUinAlbania

## SQARIM (DISCLAIMER)

BE për Bashkitë ashtu si dhe Bashkimi Evropian nuk janë përgjegjëse për përmbajtjet e materiale të komunikimit që do të prodhohen nga bashkitë fituese. Ndaj në çdo material të prodhuar duhet të evidentohet një nga pohimet e më poshtme:

### ***Për publikimet në formë të shtypur ose elektronike:***

"Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e <emrit të autorit/partnerit> dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian".

### ***Për pllakat e mirënjohjes:***

"Ky objekt (shkollë/qendër kulturore/ qendër rinore) u ndërtua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian".

### ***Për mediat sociale:***

"Ky projekt zbatohet nga XXX në kuadër të skemës së granteve "BE për Bashkitë", i financuar nga Bashkimit Evropian.

### ***Për daljet në media:***

"Projekti XXXX zhvillohet në kuadër të në kuadër të skemës së granteve "BE për Bashkitë" i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.

### ***Për video dhe materiale të tjera audio-vizuale:***


"Kjo <video/klip/poster> është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e <emrit të autorit/partnerit> dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian".




## ANEKS 1- FORMATI I PLANIT TË KOMUNIKIMIT

Lloji dhe aktivitetet e komunikimit	Qëllimi i komunikimit	Publiku	Mesazhi kryesor	Kanalet	Lidhja me aktivitet e projektit	Koha	Personat Përgjegjës	Monitorimi


## ANEKS 1- FORMATI I PLANIT TË KOMUNIKIMIT



Logo juaj



Funded by  
the European Union



EU4MUNICIPALITIES

## ANEKS 3- SHEMBULL VENDOSJA E LOGOVE NË VIDEO

Logo juaj

### Disclaimer

*Kjo <video/klip/poster> është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetem e <emrit të autorit/partnerit> dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian*



**EU4MUNICIPALITIES**



